



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2959/ 7 prot.

Datë 03.11.2025

V E N D I M
Nr. 1577 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.11.2025, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr. Elektronik A/2025/5984 dhe nr.2959/2025 prot, datë 21.10.2025, e operatorit ekonomik “M.A.K Studio” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-60621-09-08-2025, me objekt “Mbikqyrje: Ndërtim i Urës së Fshatit Vodice” me fond limit 1,875,228.31 lekë (një milion e tetëqind e shtatëdhjet e pesë mij e dyqind e njëzet e tetë pikë tridhjet e një) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “M.A.K Studio” SHPK me NIPT L014220170 dhe me adresë Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga Muhedin Llagani, Pallat 12- katësh (VALA), Kati 1, Nr. 7, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Selenicë me adresë Rruga ‘Llambi Bomban’, Selenicë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 09.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-60621-09-08-2025, me objekt “Mbikqyrje: Ndërtim i Urës së Fshatit Vodice” me fond limit 1,875,228.31 lekë (një milion e tetëqind e shtatëdhjet e pesë mij e dyqind e njëzet e tetë pikë tridhjet e një) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

II.2. Në datën 21.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2959/2025 protokoli, datë 21.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5984 e OE “M.A.K Studio” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-60621-09-08-2025, me objekt “Mbikqyrje: Ndërtim i Urës së Fshatit Vodice” me fond limit 1,875,228.31 lekë (një milion e

tetëqind e shtatëdhjet e pesë mij e dyqind e njëzet e tetë pikë tridhjet e një) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “M.A.K Studio” SHPK si edhe kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në datën 22.10.2025 “Formularin për Publikim” me Nr. 2959/1 prot.

II.3. Operatori ekonomik ankimues “M.A.K Studio” SHPK, me anë të shkresës me datë 25.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2959/3 prot., datë 27.10.2025, me lëndë **“Tërheqje nga ankimimi”** ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit duke u shprehur se: *“....ju informon se tërhiqet nga ankimimi për arsye të kapaciteteve teknike të anagzhuar gjatë kësaj periudhe në kontrata të tjera”*.

II.4. Me shkresën me nr. 2473/2 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2959/4 prot., datë 31.10.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion me anë të shërbimit postar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “M.A.K Studio” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF–60621–09-08–2025, me objekt *“Mbikqyrje: Ndërtim i Urës së Fshatit Vodice”* me fond limit 1,875,228.31 lekë (një milion e tetëqind e shtatëdhjet e pesë mij e dyqind e njëzet e tetë pikë tridhjet e një) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet:
“1. Ankimesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.
2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me nr. Elektronik A/2025/5984 dhe nr. 2959/2025 prot, datë 21.10.2025, për procedurën e prokurimit objekt-ankim, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF–60621–09-08–2025, me objekt “*Mbikqyrje: Ndërtim i Urës së Fshatit Vodicë*” me fond limit 1,875,228.31 lekë (një milion e tetëqind e shtatëdhjet e pesë mij e dyqind e njëzet e tetë pikë tridhjet e një) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “M.A.K Studio” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

